



Rrahja e qepallave (hapja dhe mbyllja e syve ) natyrore e syve (por jo ajo në bazë nervore) ka tjera përfitime përveç atyre që janë të njohura deri tani. Hapja dhe mbyllja e syve ka për qëllim lagjen e syrit e cila është e domosdoshme për mos tharjen e tij. Ky veprim pastron po ashtu syrin nga grimcat e pluhurit etj. Por, gjithashtu duket të ketë një ndikim në funksionimin e trurit dhe në nivelin tonë të vëmendjes. Hulumtuesit japonezë janë të pasionuar me këtë veprim të syrit prandaj edhe kanë studiuar për disa vite atë. Zbulimet e tyre janë botuar në revistën shkencore të njohur Proceedings of National Academy of Sciences.

Truri ynë mund të sjellë në vëmendje një numër të kufizuar të ngjarjeve të njëkohëshme, tri ose katër më së shumti. Në një studim të mëparshëm, hulumtuesit e ekipit “Tamami Nakano” të Universitetit Osaka, kanë dëshmuar se duke shikuar filmin e Mister Bean njërzit rrahin qepallat më pak në momentet kur nuk ndodh diçka e rëndësishme, do të thotë në kohën kur vëmendja mund të relaksohet.

Ata e kanë përsëritur eksperimentin, duke vendosur në tru një rezonancë magnetike mjekësore për të vështuar ndryshimet e mundshme të aktivitetit të trurit pas çdo rrahjeje të qepallave. Aktiviteti i trurit tregon se kur një tufë informacionesh arrin para syve, njeriu rrah më shpesh qepallat, një veprim i cili rrit aktivitetin e trurit dhe përqendrimin e tij. Kjo do të thotë se mbyllja e syve është një sinjal për trurin, i cil ndërpre në një moment rrjedhjen e informacioneve të arritura për t'i kontrolluar ato më mirë dhe për të përgatitur më mirë reagimin./albinfo/